

Quantified self: forma e re e shkëmbimit të të dhënave personale, sfida të reja?

Përse duhet të interesohemi për *quantified self*-in (ose “vetë-përlllogaritjen”), këtë lëvizje mirëqenieje që vjen nga Shtetet e Bashkuara dhe që pa dyshim sot po ngjall entuziazëm?

Pavarësisht nëse bëhet fjalë për aplikacione celularësh për shëndetin, balanca të ndërlidhura dhe marrës fizikë të matjes së formës, rrjete sociale të të sëmurëve etj., këto praktika të reja digjitale të *quantified self*-it bazohen mbi mënyra të marrjes automatike dhe shkëmbimit në masë të gjerë të të dhënave personale, që ndërmerren nga vetë individët dhe kjo paradoksalisht në fushën e shëndetit, e cila prek veçanërisht intimitetin e privatësisë të secilit...

Ashtu siç nënvizohet në raportin tepër interesant të CGEJET¹-së, këto praktika kanë prirje të zhvillojnë në mënyrë të thellë mënyrën e të kuptuarit të shëndetit dhe njëkohësisht të të bërit mjekësi.

Për CNIL-in dhe në vazhden e punëve të ndërmarra në kuadër të aksionit për privatësinë 2020, ishte e natyrshme të provohej analizimi më në thellësi i ndikimit të këtyre praktikave të reja mbi mbrojtjen e të dhënave personale në shëndetësi. Cilat janë përdorimet urgjente? Përse individët kanë dëshirë të vetë-përlllogariten dhe të shkëmbejnë të dhënat e tyre? Çfarë statusi u duhet dhënë këtyre të dhënave – të një lloji disi të veçantë – në kufijtë e mirëqenies dhe shëndetit? Çfarë modelesh ekonomike skicohen? A duhen përcaktuar mënyra të reja të rregullimit dhe si duhen përcaktuar në këtë fushë?

Po aq sa fusha janë për t’u eksploruar për drejtimin e studimeve, të inovacionit dhe kërkimeve të perspektivës, aq edhe veprime e aksione për t’u ndërmarrë: takime me ekspertë të fushës, testime të marrësve në laboratorin e CNIL-it, studim ekonomik të këtyre aktorëve të rinj që investojnë në fushën e shëndetësisë, etj.

Me anë të kësaj letre të 5-të të I&KP, është rasti që të bëhet një inventar paraprak i situatës. Publikime të reja do të pasojnë.

Këto punime të para konfirmojnë se vetë-përlllogaritja i korrespondon plotësisht një lëvizjeje qytetare bazuar në kontrollin e të dhënave të vetë personit por që në këtë fushë gjithashtu, e dhëna personale është thelbi i këtyre modeleve të reja të biznesit.

Ndërsa shfaqen syzet e para që lidhen në internet, mbartëse të sfidave të mëdha për mbrojtjen e të dhënave, periudha e tanishme është veçanërisht përcaktuese për të ardhmen e tregut. Duhet pra që CNIL-i të luajë edhe aty rolin e tij prej rregullatori përkrah inovacionit, gjithë duke mbikëqyrur që ai të mos çenojë privatësinë e askujt...

Sophie VULLIET-TAVERNIER,

Drejtor Studimesh, të Inovacionit dhe Kërkimeve të Perspektivës

Quantified self-i në gjirin e praktikave të reja digjitale të shëndetësisë

Përdorime të ndryshme dhe pranueshmëri shoqërore në rritje

Vetë-përlllogaritja përmbledh disa praktika heterogjene: menaxhim të buxhetit personal, aktivitete sportive, duke ndjekur evolucionin e peshës trupore, të tension arterial apo për më tepër vlerësimin e humorit, ku emëruesi i përbashkët është ajo çka matet në lidhje me mënyrën e jetesës. Përdorimet më të zhvilluara përfshijnë ushqyerjen (regjimin ushqimor, përlllogaritësin e kalorive, mbikëqyrjen e peshës trupore), ushtrimet fizike, mbikëqyrja e ndonjë faktori të rrezikshëm dhe cilësia e gjumit. Marrja dhe ndjekja e të dhënave mund të jenë pak a shumë të automatizuara. Nëse është e mundur të regjistrohen dorazi të dhënat në një tabletë apo në një aplikacion për smartphone, tendenca është që të përdoret një marrës i lidhur në internet. Mund të bëhet fjalë si për marrës të dedikuar si një peshore e lidhur në internet, për një aparat apo një byzylyk që numëron hapat apo mat tensionin, ashtu edhe për aplikacione celularësh që përdorin marrësit e një telefoni (përgjithësisht GPS dhe akselerometër) për të regjistruar të dhënat në lidhje me një aktivitet. Kjo gjithashtu përbën një shenjë që tregon se ky treg është në kulmin e zhvillimit (ose i inkuadruar), disa krijuesë smartphone-ësh po fillojnë të fusin në mënyrë të natyrshme një “univers të mirëqenies” që mundëson ndjekjen e parametrave të lidhura me mënyrën e jetesës (kalori të djegura, distancë e përshkuar,...). Disa shoqëri po shpërndajnë smartphone-ë të pajisur me marrës të dedikuar për shëndetin që mundësojnë të matet temperatura, ritmi kardiak, përqindja e glukozës apo deri edhe ndopjen me oksigjen të rruazave të kuqe. Këto praktika të reja shkojnë krahas me interesin në rritje të individëve për t’u kujdesur për trupin e tyre, shëndetin e tyre. Studimi i TNS Sofres-it “Në kërkim të E-pacientit” (prill 2013) tregon se 1 francez në 2 e ka përdorur tashmë internetin për të kërkuar apo shpërndarë informacione në lidhje me shëndetin dhe se pothuajse 30% përdorin celularin për këtë. Në rrafshin ndërkombëtar, studimi “tracking for health” – i Peë Internet (2013) zbulon se 69% e të pyeturve deklarojnë se ndjekin indikatorët e formës apo shëndetit dhe se ndërmjet tyre, pak më shumë se një e treta, japin të dhënat e tyre, prej të cilëve gjysma e bëjnë këtë me një profesionist të shëndetësisë. 19% e poseduesve të smartphone-ve kanë instaluar të paktën një aplikacion të dedikuar për mbikëqyrjen e mirëqenies së tyre. Shifrat janë mesatarisht më të larta për personat e prekur nga sëmundjet kronike. Kjo mbështet tipologjinë e *self quantifiers*-ve të përcaktuar nga kërkuesit e Orange Labs-eve¹. Ky studim vë në dukje dy logjika të tjera të *self quantifiers*-ve: “masën e rregullsisë” e cila synon që të bëhet ndarja nga praktika e keqe për ta “bërë rutinë” një praktikë të mirë dhe “masën e performancës” e cila shërben për të kontrolluar efikasitetin e një përpjekjeje specifike.

¹“Vetë-përlllogaritja”, Anne-Sylvie Pharabod, Vera Nikolski Orange Labs (maj 2012).

Të dhëna të një lloji të ri

Shëndeti është një fushë ku digjitalizimi sjell ndryshime të panjohura në përdorime dhe në sjellje, ndryshime që mbartin premtime dhe sfida të reja në çështje të të dhënave personale, qoftë për rrjetet dhe *cloud*-in për përkujdesjen e pacientëve nga distanca, jashtë vendeve tradicionale të kurimit, qoftë për Web-in si një platformë e re shkëmbimi njohurish apo deri edhe objektet dhe marrësit e lidhur në internet, guri i parë i themelit të indikatorëve që ndjekin në vazhdimësi mirëqenien, gjendjen shëndetësore.

Por risia më “shqetësuese” duket se është emergjenca për një lëvizje qytetare ku secili dëshiron të jetë aktor i mirëqenies së vetë dhe i shëndetit të vet “duke u njohur” me të dhënat e veta.

Shprehja “*quantified self*”² kristalizon esencën e këtyre praktikave ku përdoruesi gjeneron vetë të dhënat në lidhje me aktivitetet e tij të ndryshme për të njohur më mirë vetveten. Një objektiv tjetër i kësaj praktike është përmirësimi i nivelit të mirëqenies duke i fiksuar vetes objektiva ku dinamika e komunitetit online vihet në lëvizje si burim motivimi (nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave, të objektivave, të përpjekjeve...).

Zhvillimi i këtyre praktikave lidhet me uljen e kostos marrësve, me *cloud*-in dhe me rritjen e numrit të tabletave dhe smartphone-ve. Këto të fundit janë kthyer në fakt në aks qendror, duke siguruar telekomandimin e objekteve të lidhura dhe ndërveprimin e konsultimit të të dhënave të marra. *Quantified self*-i mishëron një raport të ri ndërmjet individëve dhe të dhënave të tyre. Ai përbën kështu një lëvizje veçanërisht interesante për t’u studiuar në një nismë perspektive pasi që çon në forma të shkëmbimit të të dhënave personale të llojit të ri, si në nivel modalitetesh ashtu dhe në tipin e të dhënave të përfshira.

Për këtë arsye CNIL-i ka ndërmarrë studim mbi këtë subjekt dhe tashmë ka realizuar një numër takimesh fillestare me disa ekspertë (shoqëri që prodhojnë marrësit, profesionistë të shëndetësisë, përdorues, kërkues) dhe analizë të modeleve ekonomike të aktorëve të kësaj fushe. Ai ka programuar gjithashtu realizimin e testimeve të marrësve dhe të aplikacioneve celulare. Rezultatet e hollësishme të kësaj fushate do të publikohen.

Smartphone-i, mjet i ri i diagnostikimit mjekësor?

Në janar 2012, fondacioni amerikan X-prize, synimi i të cilit është “të inkurajojë inovacionet radikale që kanë potencialin të ndikojnë pozitivisht tek njerëzimi” shpalli një konkurs (me çmim prej 10 milion dollarësh) objekti i të cilit është të shpiket një aparat që mund të mbahet në dorë, për të hetuar dhe diagnostikuar gjendjen shëndetësore. Ndërmjet projekteve, Scandanu-i paraqiti prototipin e një marrësi që mat temperaturën, llogarit ritmin kardiak dhe përqindjen e oksigjenit në gjak, e gjitha në më pak se 10 sekonda. Ai lidhet me një smartphone i cili mbledh të dhënat e

marra dhe i analizon me anë të disa aplikacioneve (kurba e evolucionit, njoftimi...) ose ia dërgon drejtpërdrejt një mjeku.

Kur mjeku t'ju rekomandojë aplikacionin tuaj celular të shëndetit³

Research2Guidance ka publikuar në mars 2013, një raport mbi tregun botëror të aplikacioneve celulare të shëndetit. Duke analizuar karakteristikat e terminaleve, kanaleve të shpërndarjes dhe të përdoruesve, studimi nxjerr në pah tre shkallë në zhvillimin e tregut. Faza e testimit (2000-2008) është periudha e shfaqjes, shumë konfidenciale, të aplikacioneve të para. Faza e dytë është ajo e ashtuquajtura e komercializimit (2008-2015) ku mbërriti smartphone-i ashtu si edhe platformat e reja të shitjes së aplikacioneve të cilat ndryshuan rrënjësisht tregun dhe perspektivën e rritjes së tij. Së fundmi, faza e tretë do të ishte ajo e integritit dhe e ripërshtatjes së aplikacioneve të shëndetit nga profesionistët e shëndetësisë.

Shpërthimi i aplikacioneve të shëndetit (17350 në 2010-n në 97119 në 2012-n) lidhet ngushtë me zhvillimin e smartphone-ve (për 69% të aktorëve të tregut, ekspansioni i smartphone-ve është motori i rritjes së aplikacioneve të shëndetit). Mbas 5 vitesh, 50% e poseduesve të smartphone-ve dhe tabletave do të shkarkojnë minimumi një aplikacion të shëndetit. Me një rritje prej rreth 60%, tregu i shëndetësisë në teknologjinë e lëvizshme duhet të kapë në 2017-n një xhiro botërore prej 26 miliard dollarësh.

Zhvillimi i këtyre aplikacioneve lidhet gjithashtu me kanalet e shpërndarjes së drejtpërdrejtë nga ana e platformave të shkarkimit. Dy fenomene të ndryshme mund të konstatohen. I pari është shfaqja e shumë aktorëve të specializuar që kanë hyrë në tregje të kufizuara në shpërndarjen e aplikacioneve të shëndetit. Në 2008-n kishte 6 platforma: sot numërohen 58 me një treg të mbizotëruar qartazi nga dy udhëheqësit e tregut (App Store e Apple-it dhe Google Play i Google-it). Megjithatë evoluimi drejt fazës së integritit duhet të ndiqte fuqizimin e kanaleve të shpërndarjes më klasike. Në 2012-n, kanali kryesor i shpërndarjes është App Store (79%), i dyti është ai i faqeve të shëndetit (33%). Në 2017-n edhe pse App Store-i do të mbetet kanal i rëndësishëm (62%), do t'i afrohen mjekët (59%) spitalet (59%) ose farmacitë (47%). Hapja e tregut i detyrohet së fundmi thellimit të eksperiencës dhe uljes së çmimeve të aplikacioneve (çmimi mesatar i një aplikacioni të shëndetit ka kaluar nga 29,67\$ në 2010-n në 7,89\$ në 2012-n). Kjo ulje e çmimit përkon me ndryshimin e modelit ekonomik. Aplikacionet japen fals gjithnjë e më tepër. Në 2012-n, nga 10 aplikacionet e para të App Store-it, përdoruesit shkarkuan 4,3 milion herë aplikacionet falas, kundrejt 300 000 për ata që paguanin. Modelet ekonomike do të evoluojnë. Në fakt, duket se mundësitë për të ardhura vërtiten tek shërbimet (58% të të ardhurave të përfutuara në periudhën 2013 dhe 2017) dhe shitjes së objekteve me lidhje në internet (26%), ku shkarkimi me pagesë përbën vetëm 9%.

³Barometri i 2-të mbi mjekët që përdorin smartphone-ë në Francë, i publikuar në maj 2013 nga Observatori Vidal tregon se 8% e mjekëve u rekomandojnë pacientëve të tyre aplikacione

Të dhëna mbi shëndetin në zemër të modelit ekonomik të aktorëve të rinj

Shoqëritë që ofrojnë shërbime të cilat mundësojnë marrjen dhe analizimin e këtyre të dhënave, nxjerrin fitimin pjesërisht nga shitja e marrësve apo aplikacioneve. Modeli ekonomik i tyre mbështetet gjithashtu tek vlerësimi i të dhënave të gjeneruara, me anë të një modeli *freemium*, nga njëra anë duke u ofruar përdoruesve përfundimtarë disa funksione të avancuara në lidhje me vizualizimin dhe analizimin e të dhënave të tyre, duke u dhënë vlerë këtyre të dhënave tek partnerët e tjerë.

Strategjia nga e cila drejtohen aktorët kryesorë të *quantified self*-it (p.sh.: Fitbit, Withings, Runkeeper) është që të konsolidohen si platformë për t'u shndërruar në "Facebook-un e të dhënave të mirëqenies e të shëndetit". Kjo strategji konsiston në nxitjen e përdoruesve për të përqendruar të dhënat e tyre duke i ofruar tek aktorët e tretë – ndonjëherë konkurrentët – për të pasur akses dhe/ose për të injektuar të dhëna tek platforma me anë të API-së. Përdoruesi përfundimtar ka interes t'i grumbullojë të dhënat e tij nëse ai gjen shërbime me vlerë të shtuar të ofruara nga këta aktorë të tretë. Reciprokisht këta të fundit kanë interes të investojnë në këtë platformë nëse ka volum të mjaftueshëm përdoruesish. Në universin "sasior" ku vlera e shtuar rrjedh nga raporti i lojërave të ndryshme të të dhënave, logjika e platformës i përshtatet veçanërisht nevojave të përdoruesve. E gjithë ajo që aktorët ekonomikë synojnë, është të arrijnë që konkurrentët e tyre t'i shndërrojnë në partnerë të ekosistemit të tyre...

Sfida të reja: çfarë kuadri ligjor?

Sfidat në fushën e mbrojtjes së të dhënave janë të ndryshme pasi që iniciativat varen nga aktorët "tradicionale" të botës së shëndetësisë ose janë të inkuadruara prej tyre (profesionistë, autoritete të shëndetësisë, laboratorë) ose vendosen nga vetë individët. Në rastin e pare, paraqitja e zgjidhjeve apo mekanizmave të rinj është i inkuadruar dhe ka si prirjen të të bëjë pjesë për shembull, në procedurat ekzistuese të marrëveshjes (të materialeve mjekësore, subjekteve të të dhënave të shëndetit...). Fushat ku duhet pasur kujdes në këtë rast janë siguria, efektiviteti i të drejtave të pacientëve...

Në rastin e shembullit të dytë, një sërë pyetjesh shtrohen:

- Statuti i të dhënave: një karakteristikë thelbësore i praktikave të përcaktimit sasior është që ato prodhojnë të dhëna të cilat gjenden në një kufi të turbullt ndërmjet mirëqenies dhe shëndetësisë.

Megjithatë të dhënat e shëndetësisë – të konsideruara tradicionalisht si sensitive – i nënshtrohen rregullave më të forta. Po për të dhënat e mirëqenies? Këto të dhëna janë gjithashtu të prirura të zbulojnë jetën intime, përfshirë edhe të dhënat më pak sensitive *a priori*: ato mund të bëjnë me dije për shembull oraret e gjumit e të zgjimit (kujdesi për gjumin), vendet e frekuentuara (gjeolokalizimi i aktiviteteve sportive), deri edhe risqet kardio-vaskulare (të dhëna që lidhen me peshën).

- Centralizmi i këtyre të dhënave: ku do të ruhen ato? Si do të sigurohen? A ka akses në to? Këto pyetje janë aq të rëndësishme sa përdoruesit mund të kenë përshtypjen se po vendosin një lidhje të drejtpërdrejtë me të dhënat e tyre meqenëse ata janë burimi i përfundimtar të tyre. Por marrëdhënia ndërmjet përdoruesve dhe të dhënave të tyre bëhet nëpërmjet ndërmjetësimit të kompanisë që prodhon marrësin apo që publikon aplikacionin. Të dhënat kalojnë fillimisht nëpërmjet serverëve të tij përpara se të shfaqen dhe shfrytëzohen nga përdoruesi. A mos duhet krijuar një kuadër i ri rregullues?
- Së fundmi shtrohen disa pyetje etike për sa i përket karakterit normativ të praktikës së vetë-përlllogaritjes. Quantified self-i duket se do t'i bëhet i detyrueshëm gjithsecilit në të ardhmen, ashtu sikurse po paraprihet nga disa praktika amerikane të sigurimeve⁴? A do të jetë anormale në të ardhmen që të mos vetë-përlllogaritesh?

Olivier DESBIEY

⁴ P.sh mendimi i shprehur nga autori Evgeny Morozov

<http://www.guardian.co.uk/technology/2013/mar/09/evgeny-morozov-technology-solutionism-interview>

Open data dhe CNIL-i

- **Smartphone-a, publikim fotosh, biometri: rezultatet e sondazheve të kryera nga CNIL-i në dispozicion të kërkuësve**

Rezultatet e dy sondazheve të kryera nga Médiamétrie dhe TNS-Sofrès-a me kërkesë të CNIL-it u prezantuan në numrat e mëparshëm të kësaj Letre IP. Njëra prej tyre përqendrohej tek smartphone-ët, tjetra për vendin e fotografive në jetën digjitale. Midis të tjerash, ato mundësuan të krijohet një tipologji e përdoruesve të smartphone-ve dhe të konstatohet ambivalenca e sjelljeve dhe e perceptimeve, sa tek respektimi i imazhit të tjetrit dhe tek dëshira për të publikuar.

CNIL-i vendos të dhënat bruto të këtyre anketave pas anonimizimit, në dispozicion të komunitetit të kërkuesve që punojnë në lidhje me këtë temë. Nëse jeni të interesuar, na kontaktoni: deip@cnil.fr

Nicolas CAROUGEAU

- **Kërkime mbi analizën e ankesave të mbërritura tek CNIL-i: rezultatet e para**

Numri në rritje i ankesave të mbërritura tek CNIL-i tregon dy fenomene. Nga njëra anë, ai dëshmon zhvillimin e mbledhjes së të dhënave personale dhe nga kjo të mundësisë së përdorimit të paligjshëm të tyre. Paralelisht ai rezulton proces identifikimi nga ana e CNIL-it si mbrojtës i të dhënave personale nga një publik gjithnjë e më i gjerë. Duke përdorur bazën e CNIL-it vërejmë se disa ngjarje mediatike të pavarura nga CNIL-i duket se e shoqërojnë këtë lëvizje. Për ta ilustruar këtë, mund të interesohemi për evoluimin e ankesave në lidhje me të drejtën e aksesit apo të kundërshtimit kundrejt Dosjes kombëtare të Incidenteve të rimbursimit të Kredive ndaj të Veçantëve (FICP). Dy faktorë kryesorë ndikojnë ankesat në lidhje me FICP-in: evoluimi i papunësisë dhe në mënyrë më të përpiktë ngjarjet mediatike të lidhura me krizën e subprimeve (çështja J.Kerviel, kriza e borxhit grek, etj.). Në fakt, evenimentet më emblematike të kësaj krize (ose grafike) i japin shkas medieve të ngrenë çështjen e kredive të këqija familjare, të cilat janë pikënisja e problemit. Kjo paraqitje mediatike duket se merr pjesë në shpërndarjen në gjirin e publikut të informacioneve mbi të drejtat e tyre të aksesit dhe të kundërshtimit në lidhje me këtë dosje. Gjithë kjo do të shndërrohet në një “mal” me ankesa pak kohë më vonë. Ndikimi i kësaj zhurme mediatike vërehet gjithashtu edhe për lloje të tjera ankesash si ato në lidhje me sektorin e telekomit apo deri edhe video-survejimit (për më shumë hollësi: <http://www.adis.u-psud.fr/espri/>).

Nicolas SOULIÉ,ekonomist

ADIS, Universiteti Paris-Sud

Një seminar pune u organizua më 9 korrik 2013 nga CNIL-i me mbështetjen e Etalab-it, në lidhje me Open Data-n dhe të dhënat personale, me pjesëmarrjen e rreth gjashtëdhjetë ekspertëve. Synimi ishte të skicoheshin disa pika drejtimi dhe zgjidhje operationale, për një zhvillim të Open Data-s në respekt të privatësisë. Bilanci i kësaj dite do të publikohet në internet tek www.cnil.fr.

Francezët dhe biometria: kërkimi i parë i CRÉDOC-ut mbështetur nga CNIL-i

CRÉDOC-u ka bërë një kërkim mbi biometrinë në jetën e përditshme, në kuadër të anketës së saj gjashtëmujore mbi kushtet e jetës dhe aspiratat e francezëve. CNIL-i e mbështeti këtë kërkim me qëllim që të vlerësohet niveli i perceptimit të biometrisë dhe pranueshmërisë shoqërore të saj. Rezultatet treguan se francezët janë përgjithësisht të rezervuar mbi përdorimin e teknologjive biometrike në jetën e përditshme, edhe pse e kuptojnë anën praktike të tyre dhe se janë veçanërisht të shqetësuar kur u duhet të pranojnë apo kundërshtojnë përdorimin e tyre.

Nicolas Carougeau

Studimi Pew 2013: “Teens, Social Media & Privacy”

Pew Research Center-i publikoi në mars të 2013-ës rezultatet e një studimi të kryer në Shtetet e Bashkuara mbi adoleshentët, rrjetet sociale dhe jetën private: *“Teens, Social Media and Privacy”*. Nga këtu del se në përgjithësi adoleshentët tregojnë një farë pjekurie në strategjitë e prezencës së tyre në internet. Në fakt, ata i japin rëndësi të madhe parametrave të konfidencialitetit: 60% e tyre kufizojnë aksesin në profilin e tyre për vetëm shokët. Nga ana tjetër, midis shokëve, bëjnë pak ndryshime parametrash. Menaxhimi i informacioneve personale të publikuara bëhet paraprakisht në funksion të përmbajtjes së tyre në vend të kufizimit apo modulimit të publikut që preket. 59% e përdoruesve preferojnë që ta fshijnë një fotografi krejtësisht në vend që të kufizojnë aksesin në të. Një tjetër strategji e përdorur për t'u mbrojtur është përdorimi i një fjalori të koduar që kuptohet vetëm nga miqtë e tyre (58%). Me gjithë këto strategji duket sikur adoleshentët nuk janë të ndërgjegjshëm për ripërdorimin e të dhënave të tyre nga aktorë të tretë – vetëm 9% e tyre ndjehen tepër të shqetësuar – ose nuk e kuptojnë se ç'interes paraqesin të dhënat e tyre për një reklamues. Ndërkohë është mjaft qetësues fakti që vetëm 4% e adoleshentëve deklarojnë se kanë shpërndarë informacione sensitive të cilat mund t'u shkaktojnë probleme atyre vetë apo prindërve të tyre.

Étienne SCOTTO d'APOLLONIA

Juliette CROUZET